

Rreth vizitës suaj të vlerësimit

Ky dokument përfshin informacion në lidhje me atë që ndodh kur ju kërkohet të ktheheni në BreastScreen Victoria për teste të mëtejshme.

Pse më është kërkuar të kthehem për teste të mëtejshme?

Ju kemi kërkuar të ktheheni në BreastScreen Victoria për më shumë teste sepse në kontrollin tuaj të gjirit (mamografi) ka një zonë që ka nevojë për hetim të mëtejshëm. Këtë e quajmë vlerësim. Shumica e klienteve që thirren për t'u kthyer në BreastScreen Victoria nuk kanë kancer të gjirit.

Sa kushtojnë testet e mëtejshme?

Në BreastScreen Victoria, të gjitha testet e mëtejshme ofrohen falas.

Me kë mund të flas përpara takimit tim?

Ju mund të flisni me një infermiere këshilluese të trajnuar përpara takimit tuaj. Ju lutemi telefononi drejtpërdrejt klinikën tuaj të vlerësimit; numri i duhur i telefonit përfshihet në të gjitha letrat e vlerësimit.

Çfarë do të ndodhë gjatë takimit tim?

Kur të mbërrini në klinikën e vlerësimit, do t'ju presë një infermiere këshilluese e cila do t'ju shpjegojë çfarë do të ndodhë. Do t'ju kërkohet të lexoni dhe të nënshkruani një formular pëlqimi/leje, në mënyrë që ekipi i vlerësimit të kryejë testet e nevojshme. Infermierja këshilluese do t'ju përgjigjet çdo pyetjeje që mund të keni në lidhje me formularin e pëlqimit/lejes dhe procesin e vlerësimit. Më pas, një ekip specialistësh do të vlerësojë zonën e gjirit tuaj që ka nevojë për hetim.

Ekipi i vlerësimit do t'ju mbështesë gjatë gjithë vizitës suaj.

Sa do të zgjasë takimi im?

Ju lutemi parashikoni deri në gjysmë dite për takimin tuaj në klinikën e vlerësimit. Mund t'ju ofrojmë një certifikatë pjesëmarrjeje që tja jepni vendit tuaj të punës.

Çfarë testesh do të më duhen të bëj?

Ju mund t'ju duhet për të bërë disa ose të gjitha testet e mëposhtme:

- **Mamografi 3D** – Në klinikat tona të vlerësimit përdorim një lloj të avancuar të mamografisë për të marrë një pamje më të detajuar të zonës së gjirit që kërkon hetim. Kjo quhet mamografi 3D ose tomosintezë. Mamografia 3D realizon disa imazhe me rreze X (zakonisht 11–25) nga kënde të ndryshme dhe i rindërton ato për të krijuar një imazh tredimensional.
- **Ekografi e gjirit** – Mund të përdorim ekografinë për të parë më në detaj indin e gjirit tuaj. Për të bërë një ekografi, ne aplikojmë xhel në gjë dhe vendosim një sondë mbi lëkurë. Ekografia zakonisht nuk shkakton dhimbje apo përahati.
- **Ekzaminim i gjirit** – Mjekja mund ti kontrollojë nëse ka ndryshime në gjë që mund të shihen ose të ndjehen.
- **Biopsi bërthamore e gjirit** – Mjekja mund të përdorë një gjilpërë për të marrë një mostër të vogël qelizash ose indi nga pjesa e gjirit që ka nevojë për hetim të mëtejshëm. Nëse ju duhet një biopsi, do t'ju jepet më shumë informacion në atë moment.

Ju lutemi diskutoni çdo shqetësim me ekipin tuaj të vlerësimit.

Cilat janë zgjedhjet e mia?

Ju mund të tërhiqni pëlqimin/lejen që na keni dhënë dhe të kërkoni ndalimin e testeve në çdo moment.

Kur do t'i marr rezultatet e mia?

Në shumicën e rasteve, do të jemi në gjendje t'ju japim rezultatet ditën e vizitës së vlerësimit. Megjithatë, rezultatet e biopsisë mund të marrin deri në 1 javë derisa të vijë. Ne do t'i dërgojmë kopje të rezultateve edhe mjekut tuaj.

Çfarë ndodh më pas?

Nëse nuk gjejmë shenja të kancerit të gjirit gjatë vizitës së vlerësimit, do t'ju ftojme të ktheheni për një kontroll të rregullt pas 2 vjetësh.


Po nëse zbulohet kancer i gjirit?

Një numër i vogël i klienteve diagnostikohen me kancer të gjirit pas testeve të mëtejshme.

Nëse gjejmë kancer të gjirit gjatë vlerësimit, do të organizojmë një takim me një mjek dhe një infermiere këshilluese për të diskutuar rezultatet dhe hapat e mëtejshëm. Më pas, do t'ju referojmë te mjeku juaj i zakonshëm, i cili do të organizojë kujdesin tuaj të vazhdueshëm.

Shumica e rasteve të kancerit të gjirit që zbulohen gjatë kontrollit janë ende në fazë të hershme. Sa më herët të zbulohet kanceri, aq më të suksesshme janë gjasat për trajtim.

Për më shumë informacion, vizitoni breastscreen.org.au



Bëni rezervimin në
breastscreen.org.au
ose na telefononi në
numrin **13 20 50**

Nëse keni vështirësi në dëgjim
ose të folur: **TTY 13 36 77**



Për më shumë informacion ose për të ndryshuar të dhënat tuaja, vizitoni **breastscreen.org.au** ose telefononi **13 20 50**



Për mbështetje për përkthim me gojë telefononi: **13 14 50**



Informacione të përkthyer:
breastscreen.org.au/translations



BreastScreen Victoria vlerëson mbështetjen e Qeverisë së Viktorias.